

**VENDIM**  
**Nr. 179, datë 7.8.2025**

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 108, DATË 23.5.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË ‘G.S.K’ SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1545/6 prot., datë 4.7.2025 “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 23.5.2025 ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve””,

konstatoi se:

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k.**

- Me vendimin nr. 254, datë 15.4.2023, i ndryshuar me vendimin nr. 151, datë 25.7.2024, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “GSK” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Ndërsa me vendimin nr. 108, datë 23.5.2025, Bordi i ERE-s, ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “GSK” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj të tretëve, duke përcaktuar: 1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj bankës “OTP ALBANIA” sh.a. (për kontratën e kredisë datë 14.4.2025). 2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “G.S.K” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/ miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërket nga këto organe. 3. Shoqëria “G.S.K” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj. 4. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm. 5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/ mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

**2. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria**

- Shoqëria “GSK” sh.p.k., me shkresën nr. 64 prot., datë 8.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1545/5 prot., datë 8.7.2025, ka përcjellë kopjen e ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë, në të cilin reflektohet regjistrimi në QKB i marrëveshjes siguruese nr. 3145 rep., nr. 1387 kol., datë 14.4.2025, e lidhur ndërmjet shoqërisë, në cilësinë e barrëdhënësit, dhe bankës “OTP Albania” sh.a., në cilësinë e barrëmarrësit/kredidhënësit, me objekt vendosjen e një barre siguruese të radhës së parë mbi 100% të kuotave dhe të drejtave që lidhen me to, si garanci për shlyerjen e plotë dhe të pakushtëzuar të detyrimeve të siguruara.

**3. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Duke marrë në konsideratë përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 108, datë 23.5.2025, rezulton se shoqëria “GSK” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, pasi ka depozituar në ERE ekstraktin historik të përditësuar të regjistrit tregtar më datë 8.7.2025, duke reflektuar regjistrimin në QKB të marrëveshjes siguruese nr. 3145 rep., nr. 1387 kol., datë 14.4.2025.

- Përditësimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar është kryer më datë 4.7.2025 dhe është depozituar në ERE brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit, duke respektuar kështu plotësisht kërkesat e vendimarrjes.

- Në këto kushte, vlerësohet se pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 108, datë 23.5.2025, duhet të shfuqizohet, pasi objekti i saj është përmbushur plotësisht dhe nuk ka më nevojë për ndjekje të mëtejshme institucionale. Në vijim, dhe për saktësi teknike të aktit administrativ, propozohet ndryshimi përkatës i pikës 5 të po këtij vendimi, nga formulimi aktual *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.”* në këtë formulim *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi.”*, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

#### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 3 e vendimit të bordit të ERE nr. 108, datë 23.5.2025, duhet të shfuqizohet.

- Si pasojë, lind nevoja për të ndryshuar edhe pikën 5 të vendimit nr. 108/2025, në mënyrë që ajo të bëjë referencë vetëm ndaj kushtit të mbetur në fuqi – përkatësisht pikës 2 – duke siguruar përputhshmëri dhe qartësi në përmbajtjen e dispozitivit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### **VENDOSI:**

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE nr. 181, datë 23.5.2025, shfuqizohet.
2. Pikat 5 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 181, datë 23.5.2025, ndryshon dhe bëhet:  
5. *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi.”*
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrît Ahmeti**